

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 30 PRILL 2026

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 25

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 25

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Rendi i ditës është shpërndarë nga sekretaria. Ka dikush diçka lidhur me rendin e ditës?

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me rendin e ditës, kam një ankesë sa i përket pikës të dytë , përse i përket procesverbalit të datës 26 mars dhe datës 30 mars duhen hedhur të ndara në votim, pavarisht se ju mund ta keni të bindur që e keni të miratuar kjo nuk ka rëndësi. Ato duhen hedhur të ndara, ose nëse ne e konsiderojmë një mbledhje t'i hedhim në votim bashkë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mbledhja e datës 30 ishte vazhdimi i mbledhjes të dates 26, ishin të njëjtat materiale që duheshin miratuara. Nëse jeni dakort të hidhen të ndara, i hedhim.

Këshilltar E.Bregu: Ne këtu po diskutojmë anën ligjore, duhet të shprehen juristët sesi duhet të verpohen. Para se të shprehen duhet të marrim parasysh faktin që njëherë thua se është vazhdimi i mbledhjes të dates 26 Mars, njëherë është mbledhje tjetër. Unë kam ndenjtur deri në fund dhe nuk dëgjova mbledhja ndërpritet këtu dhe vazhdohet në datë 30 mars. Përderisa nuk e kam dëgjuar do të thotë se janë dy mbledhje të ndryshme pavarisht se çfarë materiale ka pasur. Në këtë pikë mendoj se duhet mendimi i ekspertit pavarisht faktit të merret në konsideratë, pasi të merrremi me faktin mund të vazhdojmë me analizën se çfarë pasoja jep ky fakt. Jemi në kushtet të një mbledhje në vazhdim, e parashikuar dhe e njoftuar në seancë apo të një mbledhje të re e cila nuk u njoftua as në formë shkresore, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Edhe në raste të tjera kur kemi bërë brenda një muaji dy mbledhje, materiali i procesverbalit është miratuar në një pike dhe kemi thënë kush është dakort me procesverbalin e të dyja mbledhjeve. Këtu mund të diskutoni dhe të thoni unë jam dakort me këtë dhe jo me këtë, procesverbali ka të shkruar se çfarë kemi diskutuar në këto dy takime.

Këshilltar E.Bregu: Ky rast është i pa precedent, nuk kemi rast të mëparshëm të ngjashëm. Ne duam mendimin e ekspertit nëse është mbledhje në vazhdim apo mbledhje e re?

Pas faktit të vazhdojë ligjshmëria.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju keni marrë një përgjigje nga Prefekti.

Këshilltar E.Bregu: Sot e kemi marrë, pas 23 ditësh vonese.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Do sygjeroja ta lexonit përgjigjen që ka dhënë institucioni i Prefektit, ku citon se ka zbardhur vendimet e mbledhjes të Këshillit edhe të dates 26 dhe 30, është sqaruar dhe është institucioni që shikon bazueshmërinë ligjore.

Këshilltar E.Bregu: Nuk e kemi marrë përgjigjen ende përgjigjen sepse sot ka erdhur.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Merreni lexojeni, nuk e di kur e keni marrë. Nuk është faji im kur ju është dërguar nga Prefektura.

Këshilltar E.Bregu: Atëherë mos u bazoni tek Prefketi por thoni mbledhja e dates 30 mars ishte vazhdim i mbledhjes të dates 30?

Nëse është vazhdim duhet ta kishe shprehur në seancën e dates 26 që mbledhja do vazhdojë edhe në datën 30, nuk e ke thënë këtë dhe kjo është një shkelje e rendë ligjore.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Absolutisht jo, nëse do kshihte shkelje ligjore nuk do ishin miratuar nga Prefekti. Kalojmë në pikën e parë kush është dakort me rendin e ditës?

Ju lutem të mbarojmë me këtë kërkesë.

Këshilltar E.Bregu: Jo nuk kemi mbaruar me këtë kërkesë.

Këshilltare A.Zheku: Znj.Kryetare në lidhje me pikën 6 të rendit të ditës, komisioni i financave u mblodh ditën e henë dhe u dakortësua që të propozohet mos futet në rendin e ditës dhe do doja që kryetari apo sekretari i komisionit të citojë dakortësinë tonë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ja po e sqaroj se jam në dijeni të çështjes.

Këshilltare A.Zheku: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Patjetër do e citojmë. Në lidhje me atë futet në rendin e ditës apo jo, ka një procedurë dhe ju e dini se mblidhet kryesia dhe atje vendoset nëse materialet do futen në rendin e ditës apo jo. Në lidhje me pikën 6 ju keni konsistuar se kjo pikë kërkon konsultim, në fakt ne kemi bërë konsultim për paketën fiskale dhe kemi diskutuar gjithë tarifafat, sepse bëhet fjalë tarifafat e biletave të qëndrës. Ato kanë marrë miratim përderisa është bërë konulstim. Këto ndryshime bëhen sepse nga dy pronarë subjekti privat dhe Bashkia kalon vetëm në administrim të Bashkisë dhe kjo nuk sjell ndryshimin e tarifave dhe përderisa nuk ka ndryshim të tarifave por lehtësim të tyre besoj se nuk ka nevojë për konsultim publik për lehtësim. Ky ishte gjykimi që ne si kryesi menduam. Nëse ju nuk doni ta shikoni si lehtësim dhe nuk doni të futet në rendin e ditës ka një vendimmarrje të Këshillit. Nëse është mbajtur nga sekretaria ta lexojmë dhe të dimë edhe mendimin tuaj.

Këshilltare A.Zheku: Kur themi ndryshim, ndryshimi mund të jetë pozitiv ose negative, populli mund të mos dojë të ulet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk ka ndodhur ndonjëherë që populli mos jetë dakort me uljen e tarifave.

Këshilltare A.Zheku: Për ndryshimin e tarifave thirret konsultim publik, sepse ndryshimi i tarifave ka anë pozitive dhe negative.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ne diskutojmë për gjithë paketën dhe më vjen keq që përveç 2-3 këshilltarëve, të tjerët nuk vijnë në takime edhe tani bëheni shumë të ndjeshëm. Megjithatë jam shumë e duruar të dëgjoj atë çka ju keni raportuar.

Këshilltar A.Habip: Mes materialeve që diskutuam në komision ditën e hënë ishte edhe ky material. Opinioni ynë ka qënë meqënëse kishte ndryshim tarifa të reja dhe galeria ja kalonte në administrim Bashkisë ne menduam që të kërkonim një opinion publik nëse duhej përfshirë edhe dëgjesa publike apo jo. Ne duam të përfshijmë edhe drejtoreshën juridike e cila dha opinionin e saj atje. Pavarsisht se ne, vendimmarrja e komisionit është se nuk kishim në gjendje të jepnim ok për këtë çështje dhe vendosëm t;ja kalojmë Këshillit për dhënien e një opinion.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse ju keni kërkuar si komision dhe mirë keni bërë dhe do doja që drejtoritë para se të vijnë të jenë prezent në mbledhjet e komisioneve, shumë mirë keni bërë që keni thirrur edhe drejtoreshën juridike, meqënëse keni kërkuar mendimin e saj dhe doni ta dëgjoni si këshilltar, drejtoria juridike të shprehet.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Opinioni tim në komision ka qënë një ndryshim i një akti administrativ duhet të ndjekë rrugën që ndjek dhe miratimi i aktit. Ky është një rregull i pashkruar, ka edhe përjashtime nga ky rregull, në kushtet kur konsultimi publik bëhet kur ndryshimet janë thelbësore, ose shtohen dhe hiqen element që nuk kanë qënë pjesë e konsultimit publik. Ky ka qënë opinion im pastaj e vendosni ju si do veprohet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kryetari një sqarim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani mesa e njoh unë ligjin, vendimi i komisionit nuk pezullon kalimin në Këshill të materialit, mund të lexohet vendimi i komisionit të financave, opinion i tyre dhe të jetë pjesë e diskutimit në rendin e ditës në Këshill. Mendoj se kur t'i vijë rradha kësaj pike, t'ju them diçka se ku koniston materiali që do procedojmë dhe pastaj është vendimmarrja juaj ta votojë apo jo këtë material. Mund ta bëjmë tani ose më vonë, unë mendoj kur t'i vijë rradha.

Këshilltare M.Qelesi: Jam dakort me z.Bregu sepse në një pikë të hidhen dy procesverbale të datave të ndryshme si do votojmë me 50 %?

Ose të vihet shënim aty, të ishte ndarë në dy pika rendi i ditës, duhen të ndara sepse janë mbledhje të ndryshme dhe është fare bazike kjo gjë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kështu është proceduar gjithmonë.

Këshilltare M.Qelesi: Përderisa e fut në një pikë si do e ngre dorën unë, gjysëm dore?

Me 50 % do votoj unë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem mos u revoltoni.

Këshilltare M.Qeleshi: Në nenin 71 të rregullores, etapat e rendit paraprak të mbledhjes të Këshillit Bashkiak është pika E ku thuhet leximi i vendimit të mbledhjeve të mëparshme dhe konfirmimet e Prefektit. Mund t'i marrim këto konfirmimet e Prefektit në materialet siç na vijnë votimet, pika E ka këtë leximi i vendimeve të mëparshme dhe konfirmimet e Prefektit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Do ja u skanojmë edhe atë dhe do ja u vemë në dispozicion.

Këshilltare M.Qeleshi: Duhet të ishte bërë, është në rregullore, nuk më intereson + apo – thjesht ndjekje procedure.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse u hodhën propozime.

Këshilltar E.Bregu: Për procedurë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Për procedurë po flas, nëse nuk ju pëlqen mund të shprehni mendimin tuaj. Kush është dakort për të ndarë votimin e dy procesverbaleve?

Këshilltar E.Bregu: Për procedurë. Në lidhje me miratimin e rendit të ditës duke pasur parasysh që nuk është e qartë nëse mbledhja është e re apo vazhdimi i datës 26 mars. Pra mbledhja e datës 30 nuk është e qartë nëse është mbledhje e re apo vazhdimi i datës 26, kërkojmos marr pjesë në votim dhe kjo të shënohet në procesverbal.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Është e rregjistruar. Po e hedh në votim, kush është dakort që dy procesverbalet të votohen së bashku, siç ju është paraqitur?

PËR MIRATIMIN E DY PROCESVERBALEVE NË NJË PIKË.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 4

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 21 pro, 4 kundër, 0 abstenim.

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 22 pro, 2 kundër, 1 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS DATËS 26 MARS DHE 30 MARS 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Pika e dytë mendoj se e mori votimin dhe nuk ka nevojë të hidhet në votim.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Duhet hedhur në votim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mendova meqënëse u votua. Po e hap edhe njëherë procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 22 pro, 3 kundër, 1 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1- 31 MARS 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare E.Mitre: Përshëndetje të gjithëve, në lidhje me materialin e ndihmës ekonomike nga 6 % e fondit të kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor janë 50 familje 178 mijë e 221 lekë. Familjet përfituese nga kompensimi i energjisë elektrike janë 6 në shumën 5 mijë e 784 lekë. Ndërsa ndihmën ekonomike nga fondi i buxhetit vendor janë 11 familje në shumën 50 mijë e 121 lekë, tabelat janë bashkëngjitur materialit për familjet që hyjnë apo dalin nga skema. Ju ftoj ta miratoni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit Eda, ka ndonjë gjë nga këshilltarët? Nëse jo hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT TË STREHIMIT SOCIAL BANESA ME KOSTO TË ULËT”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare E.Mitre: Ne kemi pasur shpesh materiale të tilla, i cili synon të mbështesë individë, familje në blerjet e banesave me qëllim përmirësimin e jetesës dhe kushteve të jetesës. Prioritet i kemi të përcaktuara në material nga Drejtoria e Strehimit. Në këtë material është një ndryshim që mund t'i bëhet pikëzimit i cili është prej 100 pikësh në total dhe rubrikat të cilat janë të parashkruara në tabelë. Kushtet e strehimit 25 pikë, kushtet familjare 25 pikë, kushtet sociale 25 pikë dhe kushtet ekonomike 25 pikë, të gjitha në total bëjnë 100 pikë. Vetëm ky është ndryshimi, ndërkohë janë dy familje në pritje të hyrjes e cila është 1+1 po pas miratimit të tabelës të kushteve të pikëzimit, atëherë do parashtrohet edhe rasti i dy familje të cilat konkurojnë për këtë banesë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit Eda, ka ndonjë gjë nga këshilltarët?

Këshilltare M.Qelesi: Publikohet lista e pikëve për secilin dhe renditja në rast se kemi 2-3 raste ose më shumë?

Drejtoria e Strehimit Social M.Balli: Në lidhje me publikimin, (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje apo diskutime?

Nëse jo hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“ PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.133, DATË 18.12.2025 “ PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar për miratim disa ndryshime në vendimin nr.133 për nxënësit e arsimit të mesëm profesional. Bëhet fjalë për një ndryshim nga 3 nxënëse që janë transferuar nga gjimnazi në shkollat profesionale dhe këtëdo përfitojnë bursë e cila do llogaritet në bazë të frekuentimit të shkollës informacioni i cili do dërgohet nga Drejtoria e Shkollës përkatëse.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje apo diskutime?

Nëse jo hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

“ PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 119 DATË 27.11.2025 “ PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË KORÇË SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Pjesërisht u dha vendimi i komisionit u lexua. Do doja t’ja jap fjalën kryetarit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një sqarim pak më të detajuar, prej rreth dy vitesh funksionon në qytetin e Korçës, Galeria e Artit Dixhital e cila është mësuar falë një projekti të mbështetur nga Qeveria Shqiptare dhe që nga momenti që është bërë funksionale ka shtuar një element atraktivi të cilën nuk e kemi patur më parë në drejtim të arteve dixhitale dhe eksperiencave. Tani gjatë kësaj periudhë kjo Galeri është administruar nga një organiztë të cilën ja kemi dhënë në përdorim këtë infrastrukturë për ta menaxhuar dhe organizata ka propozuar edhe listen e saj të tarifave të cilën e kemi bërë pjesë edhe tek tarifa fiskale dhe e kemi miratuar. Në këtë hark kohor kemi mundësuar edhe ngritjen e kapaciteteve lokale dhe tani kemi gjukuar që administrimi i kësaj galerie të bëhet nga Bashkia me strukturat e saj. Ka disa avantazhe duke filluar nga fleksibiliteti për të bërë më tepër aktivitete, përshembull një nga gjërat që synojmë që të bëjmë tek Galeria e Artit Dixhital me

këtë modelin e ri është ta hapim më tepër për nxënësit e shkollave dhe pjesë të orëve të caktuara si historia të kenë mundësi t'i zhvillojnë atje duke realizuar projeksione sipas temave që ata do kenë në atë lëndë të caktuar. Kjo orë do jetë pa pagesë, tani i kemi kapacitetet të krijojmë produksione të një niveli të caktuar t'i krijojmë edhe me stafin tonë. Galeria do jetë e hapur për mënyra të tjera të marrje të kontenteve të tjera dixhitale, jemi të hapur dhe për organizata, kompani që krijojnë kontent dixhital si puna e organizatës që kemi bashkëpunuar tani. Ky administrim i ri , krijon një fleksibilitet për një rritje të kapaciteteve lokale, qoftë në krijimin e kontentit, qoftë në administrim. Krijon mundësi për të bërë më tepër për të pasur fleksibilitet në gamën e aktiviteteve që mund të realizohen, krijon edhe fleksibilitet në pjesën e çmimeve në uljen e tyre. Do jetë e lidhur edhe me një projekt të rradhës që ne kemi krijimi i laboratorit të industrisë kreative, katin e poshtëm, ne jemi duke ndërhyrje do ta rikonstruojmë, do e pajisim me pajisje dhe do ofrojmë trajnime për të rinj të rejave në fushën e industrisë kreative. Është një mësues i lëndës të biologjisë dhe do të bëjë një orë të caktuar tek Galeria, qoftë me stafin permanent, qoftë me të rinjtë që do trajnohen do kemi mundësi ta krijojmë këtë galeri sipas kërkesave. Mësuesi do ketë mundësi ta japë këtë orë në një mënyrë më tërheqëse sesa do kishte mundësi ta bënte në shkollë. Unë jam i sigurt që me atë infrastrukturë dhe duke pasur një grup të dedikuar njerëzit të cilët kanë aftësinë teknike për t'i materializuar këto aktivitete ne mund të bëjmë shumë gjëra. Ky është ndryshimi që duam të bëjmë. Në lidhje me tarifat, kemi një paketë fiskale ku janë paraqitur gjitha tarifat dhe janë miratuar dhe ndryshimet që ne po propozojmë janë të gjitha në sensin ulës, nuk kemi asgjë që të tejlakojë tarifat ekzistuese të miratuara. Nga ana tjetër dhe tarifat që propozojmë nuk i mendoj të shkruara në gur në sensing që i shkruam tani dhe nuk do i ndryshojmë më. Ne do i shohim sesi do ecin me këto tarifa gjatë një periudhe kohore, në rast se do shohim që ka nevojë për një ulje të mëtejshme të tarifave apo shtim për aktivitete të tjera. Këtu do jemi prapë do ulemi, do diskutojmë, do na vini ju me propozim që kjo të ulet ose të shtohet. Nuk mendoj se duhet të këmbëngulet kaq shumë në pjesën formale, të bëjmë dëgjuesë formale kot dhe kjo do e zgjidhë?

Ndërkohë që ajo që unë propozoj është ta miratojmë, t'i hapim rrugë Galerisë sepse momentalisht e kemi të pezulluar sepse kemi ndërprerë me organizatën ekzistuese kontratën. Ndërkohë që kemi një individ që do të organizojë një aktivitet me mjekët e Korçës në datë 14 maj dhe nuk e bëj dot se nuk kam tarifa të miratuara me modelin e ri të menaxhimit. Këto tarifa janë të gjitha në ulje, ju propozoj ta miratojmë të lemë një periudhë kohe si do shkojë me këtë model të rid he këto do jemi do flasim përsëri. Ju duket e tepërt, atëherë është dhe opsioni tjetër që për mua nuk bën shumë sens por ok, i miratojmë sot dhe bëjmë dëgjuesat që do jenë formale dhe në mbledhjen e muajit tjetër e rishikojmë edhe njëherë. Po mos e pezullojmë qoftë edhe një muaj vetëm se çdo ndryshim duhet të shoqërohet me dëgjuesë edhe një ftesë kështu miqësore për gjithë anëtarët e komisioneve nëse keni ndonjë vërejtje na vini në dijeni më vini edhe mua se nuk është se jam në hënë edhe nuk e di ç'bëhet i hapur jam edhe na i thoni se çfarë shqetësimesh keni sepse ju materialet i merrni 10 ditë para, keni kohë deri në mbledhja e komisionit të na pyesni dhe të merrni një informacion shtesë. Nuk e mendoj se duhet të jemi kaq të ngrutë, kam disa pikëpyetje e të pres derisa të vijë mbledhja e komisionit ndërkohë të marrë informacion paraprak. Tani propozimi im është ai i pari që thashë dhe pastaj qoftë me iniciativën tuaj qoftë tonën pas disa muajsh ta rishikojmë nëse do ketë vend

për rishikim. Nëse do keni ndonjë kundërshtim sepse mendoj se nuk ja vlen as ajo pjesa e politikës sepse është një ndryshim që duhet kaluar. Ta miratojmë tani bëjeni dëgjuesën për 1 muaj dhe në rast se ka ndonjë ndryshim e futim për miratim muajin tjetër por mos humbasim një muaj kot. Ky është propozimi im.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kush ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltare A.Zheku: Kam disa momente që dua të ndaj, ndjesë se për zërin për arsye shëndetësore. E para nuk po diskutojmë fare politikisht.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem nuk duhet të diskutojmë politikisht, nëse keni pyetje bëni pyetje dhe pastaj diskutimet.

Këshilltare A.Zheku: Ta marr fjalën njëherë e mirë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem ne ndjekim një procedurë të cilën duhet ta ndjekim.

Këshilltare A.Zheku: Pyetja ime është gjatë 2-3 muajve që ka mbaruar kontrata a janë zhvilluar apo jo aktivitete?

Kryetari tha janë pezulluar për shkak të ndërprerjes të kontratës dhe na thanë që pritje të kishte interes dhe nuk pati dhe do kalojë në administrimin e Bashkisë. Komplimentoj vizionin që kryetari paraqiti dhe pyetja ishte janë bërë apo jo aktivitete, kryetari tha jo, përfaqësuesi tha po janë aplikuar tarifa që kanë qënë aktive të kontratës të privatit. A është e hijshme kjo apo jo?

Sa i përket kundërshtimit të tarifave unë kam qënë e para që e kam votuar kundër sepse një familje me 4 anëtarë 30 mijë lek të shikojë një shfaqje është shumë e madhe dhe unë kam qënë e para që kam votuar kundër. Jam shumë pro të ulen tarifat dhe këtë e përgëzoj shumë, për sa i përket çështjes proceduriale apo juridike që ne duam.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në dijeninë tim por duhet ta verifikoj nuk janë bërë aktivitete, mund të jenë bërë aktivitete falas por jo me biletë sepse ne në janar mos gaboj na ka mbaruar kontrata dhe sa kohë që nuk ka qënë kontrata e rinovuar nuk ka mundësi ligjore që ai që e kishte në administrim të ketë bërë shfaqje me pagesë, e kemi vënë në dijeni dhe i kemi thënë se nuk mund të bësh shfaqje me biletë por nuk e vë dorën në zjarr.

Këshilltare A.Zheku: Pse prej katër muajsh pezull dhe nuk ka erdhur si propozim si në Këshill që të merrej në administrim nga Bashkia dhe a është kujdesur private gjatë këtyre katër muajve private?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nga informacioni që kam unë, nga janari dhe këtej nuk është bërë asnjë shfaqje me biletë. Pjesa tjetër ka qënë një periudhë kur janë bërë këto dorzimet por një pjesë e periudhës për hir të së vërtetës ka qënë një periudhë pritje ku kemi pritur të negociojmë privation për rinovimin e kontratës. Pasi kemi bërë dhe një rivlerësim të kapaciteteve tona kemi konkluduar vërtet menaxhimi nga Bashkia ka anë të mira po kemi kapacitete që ta administrojmë vetë dhe kemi arritur në konkluzionin që po, kemi mundësi për të bërë gjëra me fleksible me çmim më të

ulët edhe më tepër edhe të kombinuara edhe falas ndoshta për nxënësit e shkollave dhe ajo galeri mund të përdoret me një larmishmëri shumë më tepër sesa është përdorur deri tani. Tani në material gjendej vetëm pjesa e tarifave ndërkohë që gjithë pjesa e avantazheve të reja më vjen mirë t'ja u jepja, propozoj edhe njëherë ta miratojmë me kushtin që pas disa muasjsh pasi ta shohim si do operjme të kemi mundësi me kërkesën tuaj ta ridiskutojmë edhe njëherë pjesën e tarifave. Unë mendoj se mund të ideoen shumë aktivitete, jam i sigurt që do dalin edhe aktivitete të tjera që nuk janë listuar atje. Ky është propozim im dashamirës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Znj. Ada fjalën.

Këshilltari A.Përmeti: Si anëtare komisioni mund të cilësoj që pjesëmarrja ime në komision ka qënë e vazhdueshme dhe ka qënë edhe cilësore duke lexuar me vëmendje materialet dhe duke qënë një vlerë e shtuar si për komisionin edhe për Këshillin, mund të cilësoj se materialet na kanë erdhur vetëm ditën e shtunë dhe nuk është normale që ne të lexojmë vetëm për 1 ditë sidomos kur ato janë shumë. Tani kam dy pyetje, në lidhje me propozimet e pikës a,b dhe c nuk i gjej në paketën fiskale dhe pika 2 është që sipas statutit që menaxhohet Qendra e Artit dhe Kulturës a e ka në menaxhim Galerinë e Artit Dixhital, a kemi ne një vendim për këtë gjë?

Për pjesën tjetër jam dakort, janë çmime që shkojnë në favor të publikut dhe shumë mirë që do menaxhohet nga Bashkia për t'i dhënë një fleksibilitet sesa pjesa tjetër.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po hapësira e Galerisë të Artit Dixhital është pjesë e infrastrukturës e Qendrës të Artit dhe Kulturës dhe kontratën e ka bërë kjo qendër dhe struktura e re do jetë pjesë e kësaj qendre. Në lidhje me tarifën në pikën a,b,c (nuk ka audio). Ato që janë, janë me ulje ato që po shtohen nuk kanë qënë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kush ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltari E.Bregu: Së pari dua të korrigjoj kryetarin që njoftimet nuk i marrim 10 ditë para por zakonisht i kemi marrë 4 ditë para gjë që u evidentua edhe nga këshilltarja e Partisë Socialiste znj. Ada Përmeti. Dua ta nxis kryetarin t'i sjellë dokumentat 3 javë para që në rast se ka paqartësi të kenë mundësi që këshilltarët të shprehin sygjerimet dhe kryetari të ketë mundësi t'i korrigjojë duke i sjellë në formën e duhur. Po i sollli 4 ditë para edhe Këshilli nuk ka kohë edhe kryetari nuk ka kohë të bëjë korrigjime dhe ndaj ato materiale shtyhen për mbledhjen tjetër. E propozoj kryetarin që tha një të vërtetë që konsultimet bëhen efektivesepse publiku ka humbur interesin për shkak të mungesës të transparencës, faleminderit z.kryetar që e përmende.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ti ke marr pjesë dhe nuk kanë qënë fiktive?

Mos e përgjithëso tani.

Këshilltari E.Bregu: Më lër të mbaroj fjalën pastaj më korrigjo.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse ju mendoni se keni bërë gabim që keni qënë në konsultime publike sepse ju i ndiqni konsultimet vet prandaj.

Këshilltari E.Bregu: Faleminderit që ma ve në dukje, nëse ka diçka që ne kemi bërë shkelje na vini në dijeni në kohën e duhur. Tani ta mbaroj të lutem. Meqënëse kontrata ka mbaruar dhe aktivitetet

nuk organizohen më nga kontraktorit, unë mendoj se pyetja kryesore është a është marrë në pronësi ambienti, kush e përdor tani?

Në moemntin që e ka marrë me qira ai e ka marrë në dorëzim dhe pyetja e dytë është a ka mundësi nga ana ligjore Bashkia të vazhdojë me të njëjtat tarifa derisa të ndryshohen tarifat sepse është më mirë të vazhdohet subjekti me të njëjtat tarifa sesa të bllokohet fare për shkak se nuk bën dot ndryshime, nuk u rinovua kontrata po që se ishte marrë në dorëzim mund të ishte vazhduar. Kjo është pyetja ime. E treta duke marr shkas dhe nga diskutimet që bëri znj.Përmeti ideja është që çmimet e vendosura duhet të respektohen bazuar në një procedurë të ligjshme, duhet procedura e ligjshme sepse ne nuk mund të bëjmë këtu sa më mirë dhe lirë. Këshilli dhe këshilltarët kanë rol që vendimet dhe çmimet të jenë të drejta as të shtrembëta as të lira, ky është fokusi. Nëse ne e gjejkojmë që po e bëjmë këtë procedurë se kjo është më e lira, pse merremi me këtë punë ne?

E zabtojmë vetë sipas dëshirës dhe them pse na kërkojnë llogari, ne i kemi ulur tarifat nuk i kemi rritur, prandaj e theksoj se vendimet e Këshillit duhet të jenë të drejta.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komentet i bëre nuk e ke më fjalën për diskutime.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për pjesën çfarë them unë më ler ta mbaroj unë ti thuaj pjesën tënde, por kur thua kryetari thotë kështu pastaj.

Këshilltar E.Bregu: Më vjen keq unë kam dashur ta citoj, nëse e kam ciuar gabim më thuaj. Të njëjtën të drejtë e keni pasur dhe ju duke më cituar mua, duhet ta theksosh që mos marrësh autorësinë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë mund të kem cituar ndonjëherë por nuk citoj shtrembër. Ti more një shprehjen time në lidhje me dëgjesat dhe u përpoqe ta përgjithësosh për të gjitha dëgjesat që është gabim. Unë jo vetëm që nuk jam kundër por Bashkia e Korçës ka qënë e para që ka future konceptin e dëgjesave kur ato nuk ishin fare në linjë. Në kuadrin e një projekti me Usaid mos gaboj kemi hapur këtë lojë e dëgjesave me banorët, diskutime me banorët, marrjen e opinionëve të tyre dhe pastaj zbatim sipas atyre që kanë thënë. Tani dëgjesat përveç qasjes time janë edhe detyrime ligjore dhe jemi të detyruar t'i zbatojmë Ajo që unë thashë ishte për pikën konkrete, për këtë lloj tarife dëgjes më e mire që mund të bëhet është përdorimi i kësaj hapësire me tarifat e propozuara që janë të gjitha në ulje dhe në rast se do ketë nevojë për të bërë ndryshime të tjera pas një periudhe kohore ta bëjmë një diskutim pasi të kemi marrë një informacion tamam se kush mund të jenë nevojat, unë jam kundër dëgjesave formale dhe ti ma shtrembove dhe the kryetari më tha që dëgjesat në Bashki janë formale këtë doja të sqaroja. Tani për sa i takon është marrë në dorëzim, Anxhela të lutem.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi. Dishnica: Po është marrë në dorëzim dhe po administrohet dhe është në mbikëqyrjen e një punojëse që është në varësi të Qendrës të Artit dhe Kulturës. Tani ë fundmi jo që në moment sepse duhet të ishte në materialet që kishte sjellë kontraktori.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani në lidhje me kërkesën e dytë. Ti pranon që të vazhdojë me tarifat e larta që siç e tha dhe Alketa penalizohen kategori të caktuara sesa të miratosh këto tarifat me ulje që i japin një farë kohë.

Këshilltar E.Bregu: Thashë për periudhën derisa të miratohen tarifat, nuk thashë të vazhdueshme. Unë thashë për periudhën që nga dorëzimi derisa të vinte për miratim, a ekziston mundësia ligjore të vazhdojmë me ato tarifa dhe kur të bëhet ndryshimi vazhdojmë me tarifat e reja.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sepse modeli i funksionimit ka qënë tarifat e vjetra i mblidhte operatori privat dhe na jepte një % ne dhe nëse nuk do i mblidhte ai pse mos operojmë me tarifa më të ulëta?

Këshilltar E.Bregu: Ke humbur 4 muaj kohë pra.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: 4 sa të duash.

Këshilltar E.Bregu: Unë dua ajo që është e drejtë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ka nevojë për një periudhë kohore që të realizosh tranzicionin nga një gjendje në tjetër, nuk është çelës automat që vajte i re dhe mbarove.

Këshilltar E.Bregu: Ditën që mbaron kontrata ambienti quhet i lirua.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Besoj se e dhamë gjithë informacionin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mos ndërhy të lutem të mbarojë kryetari se po bëni pyetje- përgjigje të mbarojë kryetari.

Këshilltar E.Bregu: E kemi zgjidhur me kryetarin këtë mënyrë dhe kryetari nuk po ankohet mos u anko as ti.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Unë ankohem për pjesën e procedurës sepse drejtoj mbledhjen, meqënëse se znj.Ada Përmeti përmendi dhe pjesën e dorëzimit të materialeve në dijeninë time dhe tuajën nuk ka ndodhur ndonjëherë materialet mos keni erdhur në kohë, megjithatë një përgjigje nga Eva.

Sekretare e Këshillit Bashkiak E.Naçi: Më duhet t'ju sqaroj se përsa ju përket materialeve të dorëzuara nga ekzekutivi ju mund t'i shikoni edhe vetë sepse kanë një nr protokolli dhe ju mund t'i shikoni dhe vetë dhe kanë afat 10 ditor para dorëzimi nga ekzekutivi tek Këshilli. Përshembull relacioni i 2 viteve buxhetore është dorëzuar në datën 2 prill pasi mblidhen gjithë materialet kalojnë në procedurat e duhura dhe bazuar në ligjin nr.53 të ligjit 159 për vetëqeverisjen vendore në pika 4 thirrja e mbledhjes bëhet nga kryetari i Këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet jo më pas se 5 ditë para datës së mbledhjes. Edhe pse për një arsye teknike materialet erdhën të shtunë në mëngjes, sa i përket afateve ligjore jemi duke zbatuar ligjin dhe nuk e kemi shkelur. I kemi dorëzuar 5 ditë para zhvillimit të saj , kur është ditë punë, shkruhet ditë pune. Ky është shpjegimi im, materiali vjen gjithmonë në kohën e duhur, por materialet kanë procedura të cilat kalojnë, merren filtrohen, bëhet rendi i ditës, kalojnë në mbledhjen e kryesisë , pastaj janë gati për mbledhjen e Këshillit dhe i dorëzojmë brenda 5 ditësh.

Këshilltar E.Bregu: Minimumi nuk i jep dorë kryetarit të zgjidhë problemet dhe të korrigohet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër apo diskutime?

Këshilltare A.Zheku: Unë e di që dita e komisionit është e përcaktuar për të marrë informacione sipas komisioneve të caktuara, na vijnë edhe përfaqësues nga ekzekutivi, specialist të fushës dhe

atë ditë kishim përfaqësues ku ne kishim disa paqartësi dhe u sqaruam. Nuk e di ku duhet të drejtohem ditët e pushimit, të marrim kryetarin apo anëtar tjetër të ekzekutivit për çështjet e paqarta që kemi. Nuk e di të kemi bërë politikë në komision asnjëherë, përkundrazi të dy palët.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem mos kaloni bëjmë politikë apo jo.

Këshilltari A.Zheku: Nëse ligji kërkon konsultim publik, ne ju referuam juristet dhe juristja tha sipas ligjit ne nuk kundërshtuam asgjë në komision, thjesht kërkuam ligjin. E dyta edhe njëherë e komplimentoj kryetarin për qëllimin shumë të mirë për aktivitet, gjithashtu po e alternoj me sygjërim dhe pyetje bashkë pika E mund të marrim një sqarim ose të shtohet, mund të marrim një sqarim megjithëse e di që do kalohet pavarësisht kundërshtimeve tona. Kundërshtimet tona nuk janë marrë asnjëherë parasysh.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Megjithëse në parim je dakort me të gjitha.

Këshilltari A.Zheku: Jam dakort për vizionin edhe për uljen e tarifave. Tani në lidhje me pikën D nëse mund të shtohen në këtë pikë, cilat do klasifikohen si ekspozita, aktivitete kulturore të veçanta që bëjnë dyfishim e kësaj tarife nga 500 në 1000. Se ne na vjen Teatri i Operas nga Tirana dhe i kemi biletet 1000 lek, të specifikohen cilat do jenë konkretisht, sepse mua si lexues nuk ma jep imazhin. E dyta kjo tarifa 500 lekë për nxënës meqënëse ajo dyfishohet do dyfishohet edhe kjo apo gjithmonë ata e kanë 50 lekë?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi. Dishnica: Në komision kjo ishte për ato raste që e blejmë ekspozitën dhe për të mbuluar koston e çojmë këtë vlerë prej 1000 lek. Për ekspozitat e tjera që nuk janë kaq komplekse, nuk kanë kaq angazhim (nuk ka audio).

Këshilltari A.Zheku: Ok po shtoheni këtu, kur i ble Bashkia specifikohet dyfishimi ose lereni 500 dhe le të sponsoriizojë pak Bashkia se nuk ka ndonjë gjë. Për gjitha kategoritë e ekspozitave është një çmim normal për një familje me 4 persona 2000 lekë mund ta shohin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani edhe diçka Alketa për pjesën e këtyre tarifave të vjetra nuk është se unë bie dakort që tarifatat të jenë të larta. Kemi qënë kushtet kur nuk kishim asnjë kapacitet lokal për të menaxhuar atë Galerinë e Artit Dixhital, para dy vitesh nuk kishim asnjë ide, ishim të detyruar tarifatat që na propozontë një organizatë e cila e kishte këtë ekspertizë sepse vjen dikush dhe thotë që unë mund ta bëj këtë gjë, këto janë tarifatat time po të duash pranoje po të duash, tani çfarë duhet të bëj unë?

Është risi dhe është e vetmja që funksionin në Shqipëri dhe ata janë në fillimet e tyre. Sot jemi në kushtet që të bëjmë një menaxhim vetë, duhet të ketë tarifa sepse ka edhe kosto jo vetëm pagat e punojësve por edhe riparime, mos penalizojmë tarifatat

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z. Habip ka kërkuar fjalën.

Këshilltari A.Habip: Do bëja një propozim konkret qoftë edhe për ta hedhur në votim, duke u nisur edhe nga ato që tha kryetari dhe nga nevoja që kjo Galeri të funksionojë , për periudhën 1 mujore, 2 mujore, 3 mujore është shumë pak për të marrë një opinion mendoj që të shtrihet deri në fund të vitit kur të sillen për miratim paketa fiskale dhe atje ekzekutivi mund t mund të paraqese edhe një

relacion për periudhën 6 mujore të kësaj galerie dhe pastaj me propozime konkrete ose t'i ndryshojmë tarifatat ose të lemë këto që janë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Atëherë mesa kuptova Altini propozoi ky material të kalojë siç është deri në fund të vitit dhe pastaj të bëjmë një bilanc sesi ka shkuar dhe nëse ka nevojë për rishikim të bëhet konsultimi i paketës të këtyre vlerave dhe pastaj të pasqyrohet.

Hap procesin e votimit, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 2

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 23 pro, 2 kundër, 2 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

“ PËR FINANCIMIN ME 2 VITE BUXHETORE (2026-2027), TË OBJEKTIT “ SHTRIM ME ASFALT MIKS I RRUGËVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE, BASHKIA KORÇË”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Bëhet fjalë për një fond prej 84 milion 845 mijë e 765 lekë e planifikuar si investim, mbikëqyrje punimesh dhe kolaudim për asfaltimin e rrugëve të njësive të cilin e kemi miratuar datë 26.12.2025. Këtë fond ekzekutivi po e shtrin në dy vite 42 milion 947 mijë e 654 mijë lekë në 2026 dhe 41 milione 898 mijë e 111 lekë në 2027.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe një sqarim të vogël, ky është një propozim për të financuar në dy vite buxhetore një sërë projektsh të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, në një grup fshatrash pothuajse në gjitha njësitë administrative të Bashkisë, ju vetë e keni thënë për sa i takon infrastrukturës bazë rrugore në qytetin e Korçës dhe investimet që janë realizuar vitet e fundit kemi një gjendje shumë të mirë të infrastrukturë edhe nevojat janë vetëm në një pjesë të zonave informale. Sa i takon fshatrave nevojat janë ende shumë të mëdha dhe propozoj që ta miratojmë këtë financim për t'ju hapur rrugë edhe financimit të këtyre projekteve. Ne kemi një numër të madh fshatrash dhe të investohet në to, ndërkohë që besoj pas muajit qershor do sjellim edhe një material tjetër me grup tjetër investimesh në infrastrukturën dhe ju ftoj ta miratojmë së bashku për t'ju hapur rrugë realizimit të këtyre investimeve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltare M.Qeleshi: Diçka në lidhje me materialin, u konsomua parapsisht problemi që do shtroj unë. Materiali me zërat e punimeve domethënë një analizë kostosh që ka vetëm volumin e zërave

të punimeve dhe çmimet përkatëse për çdo zë na u dha vetëm ditën e komisionit. Është e mira që në një vlerë kaq të konsiderueshme që do ndahet në dy vjet të na jepen edhe analizat e detajuara që dhe ne të krijojmë idenë dhe të konceptojmë për vlerat e dhëna sepse duhet të votohet kjo vlerë dhe duhet të jetë e argumentuar. Ne e morëm si komision këtë material me zërat dhe çmimet por këshilltarët e tjerë nuk i kanë dhe do ishte mirë të ishte e shoqëruar .

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Do ishte shumë mirë, unë e kam thënë edhe herë të tjera, që atë që ju diskutoni në mbledhjet e komisionit, dhe duke qënë se mund të merrni një lloj informacioni shtesë nga ekzekutivi do ishte mirë të dilte me një relativim që mund t'ju shpërndahej këshilltarëve para mbledhjes të Këshillit.

Këshilltare M.Qeleshi: Mund ta mbaroj.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po ndjesë.

Këshilltare M.Qeleshi: Mirë do ishte veç dhënies të materialit në kohën e duhur, të kishte edhe një analizë çmimesh për materialin e dhënë se është zë shumë i rëndësishëm për këtë vlerë të konsiderueshme. Ku janë bazuar çmimet, një analizë të përgjithshme, se zërat e punimeve janë pothuajse njësoj në gjitha fshatrat. Nuk janë 23 fshatra janë më shumë dhe do thoja që materiali kur ka vlera të tilla edhe një analizë e çmimeve. Vë re se fshati Lubonjë ka dyshinin, domethënë saç është Vithkuqi dhe Leshnja ka vetëm fshati Lubonjë ndoshta në bazë të nevojave. Ndoshta edhe këto mund të ishin argmuntuar sepse janë vlera të konsiderueshme. Në fshatin Qatrom dhe kjo ka vlerë të konsiderueshme brenda komunës të tyre, pastaj të tjerat janë ndarë pak a shumë në mënyrë propocionale, kjo nuk ka të bëjë me faktin e nevojave të fshatrave sepse ndarja në proporcion nuk ka vlerë nëse nuk do t'i argumentojmë dhe analizojmë. Këtë kisha unë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një sqarim që ndoshta i jep përgjigje edhe pyetjes të Mirelës. Në fakt bëhet fjalë për punime të thjeshta ndërtimore, në sensin e kompliketit të punimeve, pra janë asfaltime rrugësh. Zërat janë standart, është paketa e stabilizantit dhe paketa e asfaltit, kuptohet ne ndjekim rrugën ligjore, një pjesë e zërave janë në manualin shtetëror të çmimeve dhe ti nuk je idetyruar të vendosësh çmimin në manual. Zërat që nuk janë në manualin shtetëror të çmimeve bëhen pastaj me analizë kostoje, duke marrë oferta nga tregu, duke ju referuar praktikave të mëparshme, e ka të përcaktuar ligji i prokurimit çfarë rruge duhet të ndjekë autoriteti kontraktor për të përcaktuar koston e zërave ndërtimore dhe ne zbatojmë rrugën ligjore. Fshatrat janë 24 ke të drejtë. Sa më shumë aq më mirë. Patjetër unë flas për kuartetin, nuk flas për

Këshilltare M.Qeleshi: Patjetër unë flas për kuartetin, nuk flas për.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po të jenë 24 më mirë akoma, po të jenë më shumë akoma më mirë. Sa i takon mënyrës të shpërndarjes të investimeve, patjetër ka disa kritere që Bashkia i ka parasysh, nr i përfituesve, sasoia e investimeve në rast se janë bërë disa investime rresht është koha e fshatrave të tjerë, kërkesat e banorëve janë mbajtur parasysh edhe në dëgjesat edhe në kanale të tjera që mund të na kenë erdhur apo edhe në mbledhjet e Këshillit kur kanë erdhur letrat. Nga gjithë ky informacion është bërë përzgjedhja. Pas muajit qershor do shohim edhe çfarë investime do ketë realizuar apo do kenë realizuar edhe bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe do futim edhe një grup tjetër investimesh në infrastrukturë.

Këshilltare M.Qeleshi: Si me komision si me manual, vendosja e çmimeve, ndoshta një tabelë sintetike jo analitike mund t'ju ofrohet për transparencën këshilltarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 3

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 3 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“ PËR DETAJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHITETIT PËR MBROJTJEN CIVILE PËR VITIN 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Ministria e Financave ka miratuar në datën 19 mars 2026, fondin e kushtëzuar prej 13 milion e 467 mijë e 41 lekë për Bashkinë Korçë për mbrojtjen civile. Ekzekutivi ka detajuar ndarjen sipas nevojave të NSHP-së, mbrotjes nga zjarrit dhe njësisive administrative. Konkretisht janë 4 milion e 906 mijë e 400 lekë blerje kripë për emergjencat dimërore, 1 milion e 827 mijë e 121 lekë karburant për emergjencat civile, 4 milion e 503 mijë e 220 lekë blerje dy automjetesh dhe 2 milion e 230 mijë e 300 lekë për blerje pajisjeprofonale për strukturat e mbrojtjes kundër zjarrit, komisioni vendosi t'ja kaloj Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 9 e rendit të ditës.

“PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.139 DATË 26.12.2025 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2026 DHE PBA 2026-2028 TË BASHKISË KORÇË

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Ministria e Shëndetësise dhe Mirëqenies Sociale ka miratuar fondin prej 7 milion e 166 mijë e 280 lekë të destinuar për paga dhe sigurime për 7 punojës, në kuadër të zgjerimit të shërbimit social, mbështetës për fëmijë dhe familje si dhe për fëmijë me aftësi të kufizuar. Ky fond do përdoret për 7 punojës, 2 psikologë, 4 punojës social dhe një fizioterpaist. Gjithashtu brenda këtij fondi do punësohet edhe një punojës tjetër për Galerinë e Arteve Dixhitale si pasojë e ndërprerjes të kontratës, në mënyrë që të aktizohet për menaxhimin e sallës multimediale. Ju ftoj ta miratoni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 20

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 20 pro, 3 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Tërheq vëmendjen që çdo këshilltar që do të largohet nga salla të kërkojë leje sipas rregullores. Votojmë përsëri pikën 9.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 21 pro, 2 kundër, 0 abstenim.

Pika 10 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR Z.KOSTIKA MISRASI PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA ZJARRI NË BANESËN E TIJ”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ekzekutivi ju lutem.

Përgjegjës i Emergjencave Civile A.Qazolli: Relacioni është pregatitur bazuar VKM 329 viti 2012 për ndihmë në raste fatkeqësie dhe z. Kostika Misrasi plotëson gjitha kriteret për të marrë ndihmë financiare nga Bashkia, duke plotësuar gjithë dokumentat ligjore bazuar tek kjo vkm, është vendosur për ndihmë financiare, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 11 e rendit të ditës.

“ PËR KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VKB NR. 44 DATË 26.03.2026 “ PËR MIRATIMIN E SHKËMBIMIT TË PASURIVE NR. 4/168 ZK. 8564 DHE NR.4/195, NR.4/1034 ZK 8564 MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SUBJEKTIT LARTI SHPK”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ekzekutivi ju lutem.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi. Dishnica: Në mbledhjen e kaluar kemi miratuar një material për shkëmbimin e disa pasurive midis Bashkisë Korçë dhe Subjekti Larti SHPK është bërë një gabim në material tek numri i pasurisë ku pasuria 4/168 zk.8564 duhet të ishte 4/1035 në po këtë zone kadastrale, është e njëjta pasuri thjesht ka një lapsus.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 12 e rendit të ditës.

“ PËR NDRYSHIMIN E VKB NR. 15 DATË 29.01.2026 “ PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË “ STIMULIMI I INDUSTRIISË KREATIVE” DHE PËRZGJEDHJEN E PARTNERIT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI NË QYTETIN E KORÇËS”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ekzekutivi ju lutem.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi. Dishnica: Në mbledhjen e kaluar kemi miratuar projektin stimulimi i industrisë kreative, nëpërmjet këtij projekti kemi niciuar 2 procedura konkursi, në njërën prej tyre përzgjedhim ambiente të që do marrin me qira artizanët ose sipërmarrësit e tjerë të industrisë kreative dhe procedura tjetër ka qënë për përzgjedhjen e një shoqërie që do bënte përzgjedhjen e këtij projekti. Në fund të afatit janë paraqitur vetëm 3 oferta dhe pjesa tjetër që nuk

kanë sjellë oferta, kanë pasur pretendime në afati shumë të shkurtër të marrjes tek zona e Pazarit. Afati ka qënë 1-vjeçar tek procedura që kemi miratuar dhe në këtë mbledhje është kërkuar afati për marrjen me qira të ambienteve të bëhet 3 vjet. Ndërkohë me shoqatën që do përzgjidhet është 3 vjet do qëndrojë 3 vjet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 4

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 4 abstenim.

Pika 13 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E VAZHDIMIT TË PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/ KULLOSOR PËR SIPËRFAQEN PYJORE E CILA DO T’U NËNSHTROHET PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJORE”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ekzekutivi ju lutem.

Drejtorja e Pyjeve dhe Kullotave J.Marko: Shoqëria Albpuer Shpk është pajisur me vkm nr.23 për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrik edhe eloike dhe vepra ndihmëse në njësinë administrative Mollaj, Bashkia Korçë. Në zbatim të kësaj vkm ky subjekt ka aplikuar në Ministrinë e Mjedisit për heqjen nga fondi pyjor të sip ku ndërtohen kulla dhe stacioni elektrik. Në zbatim të vkm-së 888 datë 27.12.2022 të rasteve të dhënies në përdorim dhe ndryshimit të kategorisë të përdorimi kreu 2 pika 5 dhe 6 thuhet që Këshilli Bashkiak jep dakortësinë në parim për vazhdimin e procedurave të heqjes të fondit pyjor.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Bëhet fjalë për atë që bëme edhe konsultimin publik. Ka pyetje nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 3

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 3 abstenim.

Pika 14 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT ARTISTIK PRANË QËNDRËS ARTIT DHE KULTURËS”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka dikush nga ekzekutivi që do të flasë?

Ekzekutivi: Në përputhje me rregulloren insensionale bordi artistic ka përfunduar afatin 4-vjeçar duke shprehur edhe mirënjohjen janë propozuar emra të rinj, të cilët janë përzgjedhur në mënyrë profesionale me një cv të pasur që do jenë emra të cilët do e përmirësojnë fushën e artit dhe kulturës. Janë personalitete, figura të teatrit, artit pamor, muzika, emrat i keni para. Nëse ka ndonjë pyetje.

Këshilltari S.Dinellari: Faleminderit, duke qënë se ditën e hënë pati një mungesë koherence në mbledhjen e komisionit. Së pari mbledhja e komisioneve siç edhe ju e keni vënë në dijeni është shumë e rëndësishme, për realizimin e një analize të detajuar të relacioneve që ju na paraqesni. Do bëja një apel sidomos komisionit të artit dhe kulturës që në këto vite është mbledhur apo jo 2 herë gjithsej dhe për shkak të mos arritjes të një vendimmarrje të komisionit shpesh herë ne e zgjatim procedurat edhe këtu për miratimin apo mos miratime relacioneve. Për të saktësuar në lidhje me bordin e administrimit sigurisht relacioni është mbështetur në ligjin 10352 për artin e kulturën për ndërtimin e këtij bordi në kohën kur atij i mbaron afati në 23 maj kështu që ne i paraprijmë kohës. Nuk na jep informacion i detajuar në lidhje me cv të emrave të përzgjedhur. Së dyti meqënëse është pak e paqartë edhe tek pjesa e ligjit kompetencat që ka ligji. Nëse do i referoheshin bordit të përgjithshëm ka kompetenca shumë të rëndësishëm deri në miratimin e projekteve dhe mesa unë evidentova anëtarët artistikë të bordit përveç pjesa që i shërben Bashkisë për monitorimin e financave në pjesën juridike, anëtarët e tjerë nuk e di nëse ndonjë prej tyre është banues në qytetin tonë apo jo.

Ekzekutivi: Për të bërë një cv të shkurtër të artistëve të përzgjedhur, po e filloj nga korçarët Ina Osmanlli, kompozitore, kontribut të jashtëzakonshëm në muzikë, besoj se do jetë një zë ndryshe nga ato që kemi pasur deri tani. Juljan Poloni është rregjizor, një zë korçar, banues në Korçë, autor i shumë teatrove. Mikel Temo korçar, pedagog në Akademinë e Arteve, orator i Galerisë “Guri Madhi”. Qëndrim Riani nuk është korçar por ka bërë disa teatro në Korçë, solli frymë të re në Teatrin e Korçës dhe besoj se do jetë një zë që do ndryshojë Teatrin e Korçës. Arben Skenderi është instrumentist, bahskëpunëtori jonë shumë i mirë, muzikant, professor, çelist. Besoj se 3 me 2 do jetë ekip shumë i mirë do sjellë ndryshim në cilëlsinë e kulturës të qytetit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po znj. Qeleshi.

Këshilltar M.Qeleshi: Për procedurë jo për emra se s’kemi të drejtë dhe janë shumë të nderuar Do thoja thjesht për procedurë, që u vlerësuan këto emra u ngrit ndonjë komision që vlerësoi kriteret?

Mund të ishin 10 përshembull të cilët i plotësonin dhe u ngrit ndonjë komision që vlerësoi kriteret duhet të ishte pak më e detajuar.

Ekzekutivi: Unë dua të falenderoj shumë bordin e mëparshëm i cili është pyetur sepse ata kanë përvojë dhe i falenderoj, gjithashtu ne kemi pyetur edhe njerëz që janë pjesë të Qendrës të Artit të cilët kanë shprehur pohimin e tyre për këta emra. Janë emra të padiskutuar dhe ne nuk i vendosim vetë por marrim edhe mendim.

Këshilltar M.Qeleshi: Patjetër janë emra të padisutueshëm por duhet një komision që përcakton kriteret, bën përzgjedhjen e duhur. Thjesht për procedurë kjo jo diskutim nominal.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Bazueshmërinë ligjore e dinë vetë ata. Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim. Kush është dakort?

Nëse jo e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 15 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PALNIT VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Material i cili kaloi konsultimin publik dhe mua më vjen mirë që shumë këshilltarë kanë marrë pjesë në këto konsultime. Do doja nëse ka diçka nga këshilltarët që kanë ndjekur konsultimin. Nëse nuk ka t'i japim fjalën Arjanit shkurtimisht për 1 përmbledhje.

Përgjegjës i Emergjencave Civile A.Qazolli: Dokumenti i planit vendor për emergjencat civile është detyrimi i Bashkisë nga neni 14 i ligjit 45/19 për mbrojtjen civile. Ky dokument është dokumenti i tretë që Bashkia pas vlerësimit të riskut, pas strategjisë vendore që është detyrim nga ligji. Si bazë për hartimin e dokumentit është marrë vlerësimi kombëtar i riskut që është miratuar në vitin 2021 është marrë vlerësimi vendor, strategjia vendore dhe plani i veprimit, u ngrit një grup pune me urdhër të kryetarit në bazë të draft dokumentit që u dërgua në njësinë kombëtare të mbrojtjes civile, ka marrë miratimin tërësor si dhe sygjerimin e tyre të kalojë për miratim në Këshill, është bërë dhe konsultimi siç e tha kryetaria dhe mendoj se është gati për miratim në Këshill, nëse keni ndonjë pyetje unë jam i hapur.

Këshilltare M.Qeleshi: Dakort jemi po këtë draft dokumentin sikur nuk e kemi në material.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: U dërgua njëherë kur kishim konsultimin, tani është e dyta herë.

Këshilltari M.Qelesi: Është dërguar me email?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po. Nëse nuk ka diçka tjetër nga këshilltarët e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 16 e rendit të ditës.

INFORMACION NË LIDHJE ME INVENTARIZIMIN E AKTIVEVE AFATGJATA DHE AFATSHKURTRA DHE MATERIALE TË BASHKISË KORÇË SI DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kjo pika ka të bëjë me një informacion. Kalojmë në kërkesa ankesa të qytetarëve. Kërkesë drejtuar Këshillit Bashkiak, znj. Ana Verushi. Ne Ylli dhe Nikoleta Polena, pronarë me 50 % të shtëpisë bëjmë kërkesë për lejim të vendosjes provizore të kangjellave mbrojtës në ballkone. Bashkia Korçë dhe Drejtoria e Monumenteve të Kulturës është në dijeni të situatës emergjente dhe shumë dokumenteve që janë kërkuar ndër vite, vendosja e kangjllave mbrojtës dhe është detyrim ligjor, vendosja e tyre nuk çënon fasadën e saj dhe e bën shtëpinë të banueshme edhe në katet e sipërme, ne jemi në procese gjyqësore me Ministrinë e Kulturës dhe ky proces do zgjasë shumë, duke rrezikuar rënimin e shtëpisë dhe jetën tonë. Ne duam që shtëpia të na kthehet në gjendje të përdorshme duke marrë parasysh gjendjen alarante ne duam të na bëhen kangjellat mbrojtëse. Nëse në fund të procesit gjyqësor vendimi do jetë kundër atëherë ju premtojmë me ndershmëri që do i heqim kangjellat. Në lidhje me shqetësimin e këtij çifti kam komunikuar edhe me ta edhe me insitucionin sepse ajo është një shtim monument kulture, kam folur edhe me drejtoreshën e monumenteve të kulturës, problematika e tyre nuk mundet Ministria të japë lejen për vendosjen e kangjllave pa mbarimin e procesit gjyqësor, sa të ketë një vendim gjyqësor më pas do shqyrtohet edhe problematika e tyre. Kërkesë tjetër, po bëj një përmbledhje të shkurtër. Të nderuar këshilltarë të Këshillit Bashkiak, ne banorët Mazuni Seferi, Alfred Xhafa, Petrika Shpata të lagjes 14, Rruga “ Gaço Avrazi” po ju drejtohem me këtë kërkesë me vendim të Këshillit të Ministrave me nr 552 datë 29.09.2021 e publikuar në fletoren zyrtare nr.152 të vitit 2021 është përcaktuar ndërtimi i rrugës lidhëse të

banesave tona me Unazën e Qytetit me gjatësi 40 M dhe sip 200 m2. Bashkia Korçë miratoi lejen e ndërtimit nr. 11569 datë 17.12.2019 ku përcaktohet kodi i lishencës, pervetivi i punimeve, miratimi për vnm paraprake, leja e zhvillimit. Afati i punimeve përcaktohet për një vit për të ndërtuar, perfundimi i punimeve të kësaj rruge duhet të kryheshin brenda vitit dhe gjithashtu përcaktoheshin edhe punimet që do kryheshin, kaluan mbi 5 vjet dhe kjo rrugë nuk është bërë sipas projektit por kanë mjaftuar vetëm me një çakull. Ju kujtojmë të nderuar këshilltarë që paguajmë rregullisht taksat dhe nuk na përkthehen me investime. Kemi kërkuar nga kryetari, kemi bërë dhe ankesa me shkrim dhe na është premtuar që do zgjidhet por realisht nuk ka marrë zgjidhje. Ju përmend edhe përgjigjen e marrë nga Bashkia me nr. 8087/1 protokolluar në datën 21.10.2023, bazuar në kërkesën tuaj lidhur me asfaltimin e kësaj rruge, ju bëjmë me dije se Bashkia Korçë në buxhetin e vitit 2024 ka planifikuar edhe këtë rrugë, kaluan 3 vite dhe përsëri nuk po bëhet asgjë. Ndodhur në këto kushte ju kërkojmë ju si Këshill ta konsideroni të drejtë kërkesën tonë, do pranoni edhe shtrimin me pllaka në trotuare nëse Bashkia e ka të pamundur financimin e cila kushton më pak. Unë kam folur me drejtorin e Urbanistikës dhe ai më dha një mendim që mund të kryhet sepse është një rrugë e ngushtë, e cila shfrytëzohet nga 4 familje dhe mund të bëjmë një shtrim me pllaka siç e kanë kërkuar ata. Kryetar ju lutem.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e kuptova këtë, është bërë një investim, është shtrirë, jam i njohur me kërkesën. Ne i kemi mbështetur këto familje e para për t'ju dhënë akses sepse kjo rrugë nuk ka qënë e tillë dhe këta paguanin qira dhe falë ndërhyrjes të Bashkisë ju është mundësuar kjo, pastaj ka erdhur kërkesa për investim, këto familje janë në të njëjtat kushte si familje të tjera të zonave infomale dhe kanë të drejtë të kërkojnë investime, do shohim se çfarë do bëjmë. Nuk mjafton vetëm një kërkesë për investim sepse kërkesa bëjmë të gjithë, ne operojmë në bazë të kërkesave dhe mundësive. Ne çdo kërkesë e konsiderojmë të drejtë po në bazë të kërkesë shohim mundësinë. Çdo banor që ka ngelur pa investuar në zonat formale kanë të drejtë të bëjnë një kërkesë por kjo nuk do të thotë se investimi do bëhet këtë muaj.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kam edhe një kërkesë të fundit. Drejtuar Këshillit, znj. Ana Vershur ne familja Tasho ju drejtohem me këtë kërkesë duke kërkuar mbështetjen tuaj financiare për relaizimin e një projekti shumë të rëndësishëm në fushën e turizmit në zonën tonë. Familja jonë është iniciatore e të vetmes ski pistë në Shqipëri në Dardhë, me shumë sacrifice kemi arritur të krijojmë një atraksion që ka shërbyer edhe për promovimin e turizmit në vend. Aktualisht jemi në fazë zhvillimi dhe me mbështetje të Federatës së Skive, miqve, familjarëve si dhe kredi të marra bëmë të mundur blerjen e një teleferiku i cili ka mbërtiur në pistën tonë dhe duke qënëse ka rëndësi për pistën tonë ju lutem kërkojmë mbështetjen tuaj financiare për montimin e tij, ne mbetemi të gatshëm për çdo infomacion shtesë. Duke ju falenderuar për kohën tuaj dhe duke ju uruar punë të mbarë. Me respekt familja Tasho! Nuk e di se çfarë kërkojnë ne sepse vendosja e këtij teleferiku, kërkon më shumë se një vendimmarrje nga ana jonë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në parim dua ta falenderoj Maqon vetë për atë iniciativë të marrë private apo familjare, i kanë dhuruar Korçës një atraksion që nuk e kanë zonat e tjera malore. Për këtë jam falenderues dhe dua t'i mbështes por gjithnjë brenda tagrit ligjor dhe mundësive. Të njëjtën kërkesë e kemi marrë edhe ne si Këshill, ja kam nxjerrë Drejtorisë Juridike dhe Financës në rast se ka ndonjë hapësirë ligjore që e shoh të vështirë. Anxhela ka ndonjë hapësirë? Në rast se do kishim një hapësirë do ju kërkoja me shumë dashamirësi ta mbështesnim për ta mbajtur si pistë por edhe për ta modernizuar. Ky teleferik do tërhiqte shumë vizitorë, nëse nuk kemi hapësirë ligjore nuk kemi si e ndihmojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka dikush nga këshilltarët diçka?

Këshilltare M.Qeleshi: Një pyetje kisha unë ndoshta nuk kam informacion por për banorët e Barçit ka transport publik Korçë- Barç? Ma kërkuan dhe nuk dija t'ju jepja përgjigje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e di por mund të pyes e të jap përgjigje.

Këshilltare M.Qeleshi: Ma shtruan si shqetësim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të marr një informacion por ideja është gjithë fshatrat e Korçës bazë të ligjit për transportin, duhet të kenë këto linjat rrethqytetase. Roli i Bashkisë është të vendosë kriteret dhe të organizojë konkurset. Në rast se x fshat për x arsye nuk ka asnjë të interesuar për të ofruar këtë shërbim pastaj nuk ka asnjë hapësirë Bashkia ta zgjidhë me mjete publike. Bashkia thjesht ka kompetencën të hartojë kriteret, dokumentacioni kush bëj më tepër pikë ta zgjidhe. Në këto fshatrat afër bëhet e vështirë sepse shtohet numri i mjeteve private.

Këshilltare M.Qeleshi: Të marrim një informacion po apo jo dhe zgjidhja është hapi i dytë. Unë e bëra pyetjen ka apo nuk ka sespe ata ma shtruan si pyetje edhe unë nuk e dija, hapin e parë doja të sqarhesha sepse mund të ketë dhe ata nuk e dinë. Hapi i dytë është procedura.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka dikush nga këshilltarët diçka?

Këshilltar E.Bregu: Kam një çështje që ma kërkuan kryepëlehtë e fshatrave Vinçan, Porodinë dhe Damjanec. Bëhet fjalë për një projekt që ka lidhje me investimin e urës të Turanit, është një urë në kushte të vështira. Doja të dija nëse është e përfshirë në projekt.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Në lidhje me urën e Turanit që donin ta kalonin nga Vinçani?

Këshilltar E.Bregu: Të përfshihet një urë tjetër, është më e vogël.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E kuptova është kjo rruga e Porodinës këtej nga Vinçani. Ky është një projekt që do bëhet nga ARSH me fonde nga Banka Kombëtare kjo ura e madhe e Turanit. Është e vërtetë që edhe kjo ura tjetër është në kushte të vështira po nuk marr përsipër të them do përfshihet apo jo por do e përcjell si kërkesë.

Këshilltar E.Bregu: Mendoj se ja vlen se ajo është e rrezikshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E kuptova por puna është sa kanë mundësi këta, një interesim do e bëj patjetër. Barçi prej dy vitesh nuk ka linja rrethqytetase për shkak se ai djali që e kishte linjën e ka lënë dhe nuk ka pasur interes tjetër, si duket nuk ka shifra, janë disa fshatra, është e vështirë sepse siç thashë ne bëjmë vetëm procedurën, vendosim kriteret, bëjmë konkursin ppor nuke vendosim ne.

Këshilltare M.Qeleshi: Ndonjë zgjidhje lehtësuese?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E vetmja gjë që mund të bëjmë ne, është të flasim me këto linjat rrethqytetase që janë më të fuqishëm, t'ju themi a ka mundësi, a ekziston si opion, pastaj me zor nuk i marrim dot.

Këshilltare M.Qeleshi: Ok po kijeni parasysh sepse janë shqetësimi i banorëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka tjetër nga këshilltarët?

Këshilltare L.Alidinaj: Tek ish- Parku i Industrisë atje ku bëhen ndërtime se pashë janë hedhur dhera, mos është momenti të shikohet ajo rruga dhe të lihet hapësirë për ato dy lagjet “ Pandi Krëku” dhe “ Kiço Shkodrani”, të bëhet lidhja dhe doja të theksoja që ato kabllot atje përballë me karburantin e qytetit janë të varura, nuk janë të Ndërmarrjes Elektrike por ndoshta si Bashki mund të ushtroni autoritetin tuaj sepse janë afër trotuarit. Pjesa e kanalit atje, ato barishtet janë rritur aq shumë sa kanë dalë mbi rurgë, pjesa karshi karburantit. Vijëzimet përballë me Fabrikën e Duhanit janë dy rrugë atje që është tabela për vijëzimet për kalim kalimtarësh duhet të bëhet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për pjesën e vijëzimeve, tani do lidhim kontratën shumë shpejt për të filluar pjesën e akseve rrugove në qytet. Pjesë e procesit të vijëzimit është edhe Unaza, në rast se bëhet fjalë për vija të bardha të këmbësorëve, patjetër mund t'i realizojmë edhe me punojësit e ndërmarrjes. Pastrimin e përroit po, këtë rrugën e kemi konsumuar edhe në takim vjet, ideja është që ajo si pronë, është pronë private dhe nuk mund të bësh rrugë në pronë private që ta bësh këtë duhet të shpronësohet, por shpresoj ngaqë është sipërfaqe e madhe të ketë ndonjë interes për tu zhvilluar nga dhe shpresoj që meqënëse është zonë e madhe të ketë interes për tu zhvilluar dhe do dojë një rrjet rrugor dhe në këtë moment mund ta shohim mundësinë e investimit.

Këshilltare L.Alidinaj: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nëse do bëhet një rrjet rrugor do i shërbejë edhe kësaj bllokut që mund të zhvillohet por edhe lidhjes me infrastrukturën tjetër. Në lidhje me kabllot, ne kemi filluar një process disiplinimi të kabllave të operatorëve të internetit dhe televizorit, kemi filluar në disa rrugë dhe procesi i lajmërojmë sot do sistemoni këto rrugë kemi qaq kohë afat në rast se nuk e bëjnë ja u presim edhe i detyrojmë me force të themi ta mirëmbajnë rrjetin që ata e kanë pronë të tyre dhe ju shërben për qëllime biznesi do e shohim edhe këtë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit kryetar. Faleminderit dhe ju këshilltarë për takimin e sotëm. Rabiani ka bërë thjesht kërkesë për pjesëmarrje në mbledhje. Mirë u takofshim mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI